REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 146/22
Datë/Datum. 25.05.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Muhamet Kurtishaj	**18.05.2022**	**25.05.2022**	**Nr.146/22**
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 17.05.2022, OE **"Ballkan Petrol" SHPK** ka parashtruar ankesën me **nr.146/22**, kundër vendimit për dhënie të kontrates, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me vaj, antifriz dhe glukol për Ndërtesat Qeveritare dhe Pallatin e Drejtësisë"** me nr. te prok. 214-22-1056-121, iniciuar nga autoriteti kontraktues **Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, **furnizim**, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **70.000,00 €.**

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, më Nr.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE të OE "Ballkan Petrol" SHPK

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 1 i LPP-së - Qëllimi
- Neni 6 i LPP-së - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 28 i LPP-së - Specifikimet Teknike
- Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 72 i LPP-së - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- Neni 36 i RrUOPP-së - Hapja e Tenderëve Elektronik

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

Me qëllim të sqarimit të situates për Ekspertin Shqyrtues dhe Panelin Shqyrtues të OSHP-së, më poshtë po e paraqesim në menyrë kronologjike rrjedhën e procedurës së këtij aktiviteti të prokurimit respektivisht arsyet e eliminimit tonë nga ana e AK-së:

Fillimisht ju bëjmë me dije se arsyet e eliminimit të ofertës sonë nga autoriteti kontraktues janë të karakterit teknik/elektronik dhe nuk përkasin në domenin tonë si OE.

Me datë 28.04.2022, Autoriteti Kontraktues, në platformën E-prokurimi ka publikuar njoftimin mbi Vendimin e AK dhe Letrat Standarde për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me vaj, antifriz dhe glykol për Ndërtesat Qeveritare dhe Pallatin e Drejtësisë" me numër prokurimi 214-22-1056-1-2-1, numër të brendshëm 214-22-009-121. Në letrën Standarde për eliminimin e ofertës së kompanisë sonë, "Ballkan Petrol" SH.P.K. e cila ka qenë oferta më e favorshme financiare, është cekur se:

Ju nuk keni dorëzuar Deklaratën Nen Betim.
Nuk keni dorëzuar sigurimin e tenderit me ofertën e juaj financiare siç kanë qen kërkesat ne njoftimin për kontratë dhe ne dosjen e tenderit.
Nuk keni dorëzuar listën e referencave, duke dëshmuar me referenca për furnizimet e ngjashme për këtë AP.

Ndërsa ne jemi të sigurtë se gjatë ngarkimit të dokumenteve në platformën e E-prokurimit me datë 25.03.2022, ne i kemi ngarkuar të gjitha dokumentet e nevojshme në rubrikën përkatëse, si dëshmi paraqesim pjesën e shkëputur në formën print screen nga formulari B66 Formulari i dorëzimit të tenderit i gjeneruar automatikisht nga E-prokurimi:

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	Përmbajtja e ofertes-06_2022.pdf
2.	1_Neni 13-Sigurimi i tenderit.zip
3.	2_Neni 6-Evidenca e pershtatshmerise se ofertuesit.zip
4.	3_Neni 7-Evidenca e pershtatshmerise profesionale.zip
5.	4_Neni 8-Evidenca e gjendjes ekonomike dhe financiare.zip
6.	5_Neni 3-Deklarata për specifikacionin teknik.zip
7.	6_Neni 9-Evidenca mbi mundesite teknike dhe profesionale.zip
8.	7_Lista e kontratave dhe referencat.zip

Dëshmi: B66 Formulari i dorëzimit të tenderit

Me datë 29.04.2022 duke qenë të bindur se ne i kemi ngarkuar në platformën e E-prokurimit gjitha dokumentet e nevojshme, ne ju kemi drejtuar me një shkresë KRPP-së, Departamentit të Teknologjisë Informative që ta dëshmoj nëse dokumetet janë ngarkuar në mënyrë të rregullt në platformë.

Dëshmi: Kërkesa për informacion e dates 29.04.2022, te dorëzuar tek KRPP përmes e-mailit.

Ne fuqishëm besojmë se problemi qëndron tek AK me rastin e hapjes së ofertës sonë, pasi që të njetit kanë krijuar çelsa të dyfishtë të hapjes për të njejten procedurë- fakt i konfirmuar nga KRPP përmes e-mailit të dates 05.04.2022 , me te cilin e-mail i kanë kthyer përgjigjje AK në e-mailin e datës 31.03.2022 dhe të njejten informatë KRPP e ka përcjellur edhe tek ne me datën 29.04.2022 pas kërkesës tonë për infomacion dorëzuar në KRPP me datën 29.04.2022 dhe ky fakt ju ka shkaktuar probleme teknike me rastin e hapjes së ofertave respektivisht ofertës sonë. Po ashtu KRPP me të njejtin e-mail e ka informuar AK se për të njetin aktivitet të prokurimit nuk duhet të rikrijohen çelsat privat gjatë përgaditjes së korigjimit të procedurës (B54) nëse korigjimi bëhet që të vazhdohet/ndryshohet afati i fundit për dorëzim/hapje të ofertave.

Dëshmi: e-mailit i KRPP-së i datës 05.04.2022 , me të cilin e-mail i kanë kthyer përgjigjje AK në e- mailin e datës 31.03.2022

Po ashtu pas qasjes në dokumente në AK dhe pas marrjes së ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, "Inter Trading" shpk, kemi vërejtur se i njejti ka ofruar disa nga produktet me prodhuesin LUKOIL, i cili bazën e themelimit e ka në Rusi.

Gjithashtu ju njoftojmë se prodhuesi LUKOIL është në listën e subjekteve nën sanksione që nga viti 2014 me Vendim të Qeverisë së Kosovës.

Për njohurinë e juaj ekzistojnë disa Vendime të mëhershme të Organit Shqyrtues të Prokurimit ku OE në fjalë e ka shpallur të papërgjegjshëm pikërisht për ofrimin e produkteve LUKOIL dhe me këtë e kanë zbatuar Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 09/196, datë 17.09.2014 për sanksione ndaj kompanisë LUKOIL.

Për keto fakte ne e kemi informuar AK me kerkesat për rishqyrtim dhe përsëri e cekim se mbetet nën përgjegjësin e Autoritet Kontraktues por tani edhe të OSHP-së që ta verifikon nëse Qeveria si organ kompetent

lejon që malli i prodhuesit LUKOIL, i cili bazën e themelimit e ka në Rusi të pranohet dhe shfrytëzohet nga institucionet publike të Republikës së Kosovës.

Njëashtu ju bëjmë me dije se AK ka rekomanduar për shpërblim me kontratë një OE, i cili ka ofruar çmim pothuajse dyfish më të lartë se oferta jonë (69,785.20€ kundrejt me 38,693.38€), me që rast i ka shkatuar dëm buxhetit të Kosovës dhe interesit shoqëror në këtë krizë financiare në vlerë prej 31,091.82 € (tridhjetenjëmijë e nëntëdhjetenjë euro e tetëdhjetedy cent).

Për kunder gjitha fakteve të lartëcekura udhëheqësi i zyrës së prokurimit i AK-së, respektivisht autoriteti kontraktues me datën 10.05.2022 nxjerr vendim me të cilen refuzon kërkesen për rishqyrtim të dorëzuar nga ana e jonë si të pa bazuar, duke konstatuar gabimisht ose me qëllim se kinse asnjërën nga pretendimet dhe nenet e cekura nga ne nuk janë të bazuara dhe në pretendimin dhe sqarimin tonë rreth ngarkimit të dokumentacionit, përkundër sqarimeve edhe të KRPP-së me e-mailin e dates 05.04.2022 me të cilin e ka sqaruar për AK se ne kemi filluar dhe kemi ngarkuar në platformën e E-prokurimit me datën 18.03.2022 ora 10.03 një numer të caktuar të dokumeneteve të cilat janë enkriptuar me çelsat e dates 23.02.2022 si dhe me daten 25.03.2022 ora 09:38 ne kemi ngarkuar dokumentet (pershkrimin e çmimeve, formularin e ofërtes dhe kemi proceduar me dorëzim të ofertës) e të cilat dokumente janë enkriptuar me çelsat e datës 18.03.2022, përkundër kësaj AK e arsyeton veprimin e komisionit të vlerësimit, si vijon:

Sa i perkete pretendimit tuaj citojmë: Gjatë ngarkimit të dokumenteve në platformë me datë 25.03.2022 ne i kemi ngarkuar të gjitha dokumentet e nevojshme në rubrikën përkatëse – dëshmi formulari i gjeneruar nga E-prokurimi B66 Formulari i dorëzimit të tenderit, dhe se Autoritetin Kontraktues –Ministria e Punëve të Brendshme gjegjësisht komisioni i vlersimit krahasimit dhe verifikimit te ofertave, nuk e ka bërë vlerësimin si duhet, ky konstatim i Juaj, nuk qëndron, sepse komisioni vlerësues nuk ka mundur ta bëjë vlerësimin komplet të ofertës suaj, pasi që nuk ka arritur ta shkarkojë ofertën komplet tuajën.

Sistemi nuk na ka lejuar që të shkarkojm ofertën tuaj, sepse nuk keni vepruar në pajtueshmëri me *Nenin 25.8* të **Rregullave dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, OE duhet të ri-krijoj dhe të ri-dërgoj Ofertë tjetër në rast se ndryshohet statusi i procedurës dhe vazhdohet me fazë të tenderimit** citojmë:

25.8 Nëse është e domosdoshme që procedura e prokurimit të pezullohet gjatë fazës së tenderimit, atëherë ZPP nëpërmjet funksionit "Ankesat" pezullon procedurën duke dërguar statusin e procedurës "në apel".

Në këtë rast:

a. sistemi automatikisht pamundëson hapjen e ofertave deri në një vendim lidhur me ankesën;

b. të gjitha ofertat e dorëzuara deri në momentin e pezullimit do të fshihen nga sistemi dhe që është e domosdoshme që ofertat e OE të ri-krijohen dhe të ri-dërgohen në rast se ndryshohet statusi i procedurës dhe vazhdohet me fazë të tenderimit;

c. përdoruesi i sistemit (ZPP), përveç ndryshimit të statusit të procedurës "në apel", duhet të ngarkoj vendimin për pezullim ne mënyre qe përdoruesit e OE të informohen që hapja e ofertave është pezulluar deri në një vendim lidhur me ankesën; ne vendimin për pezullim ZPP duhet të specifikoj/ përshkruaj domosdoshmerisht paragrafin paraprak (paragrafin (b)).

d. përdoruesi i sistemit (ZPP) pas vendimit mbi ankesën duhet që nëpërmjet korrigjimit të procedurës (B54) të bëjë ndryshimin e statusit të procedurës dhe të bëjë çfarëdo ndryshimi të nevojshëm për procedurën përkatëse;

Gjithashtu në këtë rast, sistemi kërkon ri-krijim të çelësave për hapje të tenderëve.

Me arsytimin e lartëcekur AK e arsyeton gabimisht apo qëllimshëm veprimin e komisionit të vlerësimit duke u bazuar gabimisht në nenin 25.8 të Regullave dhe Udhezuesit për Prokurim Publik sepse kjo dispozitë merret për bazë në rastet kur një aktivitet i prokurimit në fazën para dorëzimit të ofertave, pezullohet për shkak të ndonjë ankese të parashtruar nga ndonjë operator ekonomik dhe deri sa të trajtohet ankesa kalon afati i paraparë për dorëzim dhe hapje të ofertave që AK e ka paraparë me rastin e publikimit të njoftimit për kontratë dhe dosjen e tenderit në platformen e E-prokurimit dhe pas marrjes së vendimit mbi ankesen AK është e obliguar që të bëjë korigjim të procedures (B54) dhe ndryshim të statusit të procedures në këtë rast AK duhet të ri-krijoj çelësat për hapje të tënderve dhe per shkak te krijimit të çelsave të ri sistemi i fshinë ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomik dhe me këtë rast operatorët ekonomik duhet të rikrijon ofertat dhe të ringarkojnë në platformë. Ndërsa në rastin konkret AK ka bërë shtyrje të afatit të dorëzimit të ofertave në fazën para kalimit të afatit të paraparë për dorëzim dhe hapje të ofertave dhe pa pas asnjë ankesë të dorëzuar nga operatorë ekonomik si dhe pa marr asnjë vendim për pezullim të aktivitetit dhe se KRPP me e-mailin e dates 05.04.2022 shumë qartë e ka sqaruar se sistemi i E-prokurimit elektronik nuk e parasheh ri-krijimin e çelsave privat gjatë pregaditjes së korigjimit të procedurvs (B54) nëse korigjimi bëhet që të vazhdohet/ndryshohet afati i fundit për dorëzim/hapje të ofertave. AK nga praktikat e deri tashme në rastin konkret është dashur të kërkojë ndihmë nga KRPP që të ju mundësohet hapja e ofertës tonë komplet, me qëllim që të na trajtojnë barabartë me ofertat e operatorëve ekonomik tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit e jo për shkak të gabimeve të veta që kanë rikrijuar çelsa të ri më rastin e shtyrjes së afatit të dorëzimit dhe hapjes së ofertave të na eliminojnë dhe dëmtojnë neve që kemi dorëzuar ofertë të përgjegjshme dhe me çmim më të lirë dhe në të njeten kohë të rekomandojnë për shpërblim me kontratë një OE, i cili ka ofruar çmim pothuajse dyfish më të lartë se oferta jonë (69,785.20€ kundrejt me 38, 693.38€), me që rast do ti shkatojnë dëm buxhetit të Kosovës dhe interesit shoqëror në vlerë prej 31,091.82 € (tridhjetenjëmije e nëndhjetëenjë euro e tetëdhjetedy cent).

Po ashtu udhëheqësi i zyrës së prokurimit i AK-së, respektivisht autoriteti kontraktues me vendimin e nxjerr me datën 10.05.2022 me të cilën refuzon kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar nga ana e jonë si të pa bazuar, me qëllim apo pa qëllim fare nuk e trajton pretendimin tonë që kemi cekur në kërkesen për rishqyrtim që ka të bëjë me atë se operatori i rekomanduar për kontratë ka ofruar disa nga produktet e prodhuesin LUKOIL, i cili bazën e themelimit e ka në Rusi dhe se i njeti prodhuesi Lukoil është në listën e subjekteve nën sanksione që nga viti 2014 me Vendim të Qeverisë së Kosovës.

Për njohurinë e juaj ekzistojnë disa Vendime të mëhershme të Organit Shqyrtues të Prokurimit ku OE në fjalë e ka shpallur të papërgjegjshëm pikërisht për ofrimin e produkteve Lukoil dhe me këtë e kanë zbatuar Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 09_196, datë 17.09.2014 për sanksione ndaj kompanisë Lukoil.

Nga faktet e lartë cekura po ashtu shihet qartë se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 të LPP-së ku qartë specifikohet se qëllimi i ligjit për prokurim publik është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla si dhe në kundershtim me paragrafin 1 të nenit 6 të LPP-së ku specifikohet se, të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Me qëllim që të trajtohen të gjithë operatoret ekonomik në menyrë të barabartë sipas nenit 7 dhe 59 të LPP-së,

si dhe me qëllim që të kursehet buxheti i autoritetit kontraktues duke pas parasysh se oferta jonë financiare është me e lirë se të gjitha ofertat e OE pjesmarres në këtë aktivitet prokurimit, e në veqanti është më e lirë në vlerë prej 31,091.82 € (tridhjetenjëmije e nëndhjetëenjë euro e tetëdhjetedy cent) se sa oferta e OE të rekomanduar për kontratë nga AK, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues, që me rastin e shqyrtimit të kësaj kërkese dhe në mungesë të ofertave të përgjegjshme, të nxjerr:

VENDIM

Të APROVOHET si e bazuar ankesa e OE Ballkan Petroll.

Të ANULOHET vendimi i Autoritetit Kontraktues ky aktivitet i prokurimit kthehet në Ri-Vlerësim. Me rastin e Ri-vlerësimit të ofertave Autoriteti Kontraktues të obligohet që të bëj vlerësim të drejtë dhe të pa anshëm.

KRITERET PËR VLERËSIM

Te vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore.

Autoriteti kontraktues nuk ka eleminuar me arsyen se nuk ka dorëzuar Deklaraten nen Betim, nuk ka dorzuar sigurimin e tenderit dhe nuk ka dorëzuar Listen e referencave per furnizime te ngjashme.

OE ankues pretendon se ai i ka dorzuar te gjitha dokumentet e kërkuara, mirëpo problemi ka qene te AK qe nuk ka mundur ti shkarkoj ato dokumente nga Platforma elektronike dhe ka rekomanduar ofertën me çmim shume me te larte se oferta e tije.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës se OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Komisioni i vlerësimit pas kontrollimit ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit te tenderëve per kete aktivitet te prokurimit, konstaton dhe vlerëson qe operatori ekonomik i cili i plotëson kriteret eshte "Inter Trading Company" me çmimin e ofertës prej 69.785,20 €.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Nuk ka marre eksperti shqyrtues informacion shtese.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

OE ankues është pale e interesit ne këtë aktivitet te prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjti është dhënë vlerësim tjetër).

Nuk ka pasur vendim te me hershem për këtë aktivitet te prokurimit.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

Nuk kemi devijim nga praktikat e me hershme.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "Ballkan Petrol" SHPK

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Pretendimi i OE ankues eshte se AK e ka eleminuar ofertën tone ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se me arsyetimin se nuk kemi dorzuar Deklaraten nën betim, Sigurimin e tenderit dhe listën e referencave per furnizime te ngjashme edhe pse ne i kemi ngarkuar këto dokumente ne Platformen e KRPP-se, mirëpo AK nuk ka arritur ti shkarkoj ato dokumente per shkak te krijimit te çelsave të dy fishtë gjatë hapjes së kësaj procedure- fakt i konfirmuar edhe nga KRPP përmes emailit të datës 05.04.2022 si përgjigje që i është kthyer AK-së për këtë çështje. Me këtë rast AK-ja nuk ka respektuar neni 7 dhe 59 të LPP-së, si qëllim që të kursehet buxheti i autoritetit kontraktues duke pas parasysh se oferta jonë financiare është me e lirë se të gjitha ofertat e OE pjesmarres në këtë aktivitet prokurimit, e në veqanti është më e lirë në vlerë prej 31,091.82 € se sa oferta e OE të rekomanduar për kontratë nga AK. Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eleminimi i OE ankues nga ana e AK është bërë për shkak se AK nuk ka arritur ti shkarkoj të gjitha dokumentet e ofertës dhe në procesin e vlerësimit të ofertave kanë munguar dokumentet për të cilat është eleminuar kjo ofertë.
Tani shtrohet pyetja, veprimet e cilës palë kanë ndikuar që oferta e OE ankues nuk ka arritur të shkarkohet në tërësi nga ana e AK-së. Sipas përgjigjës së KRPP-së të datës 05.04.2022 që i ka kthyer AK-së thuhet se:

"Sipas verifikimit në sistemin e prokurimit elektronik evidentohet që problemi me shkarkim të plotë të ofertës së OE Ballkan Petrol është si arsye e çelsave të dyfisht të krijuara për të njëjtën procedurë"

Pra sipas përgjigjë së KRPP-së, rezulton se veprimet e AK kanë ndikuar në dyfishimin e çelsave në sistemin elektronik dhe si rezultat i kësaj nuk është shkarkuar e gjithë oferta e OE ankues.
Situata të tilla nuk parashihen në dispozitat e RRUOPP sa i përket dorëzimit elektronik të tenderëve për ti dhënë një zgjidhje.
Megjithëatë eksperti shqyrtues mendon se nuk mundet të diskriminohet një tenderues për shkak të veprimeve të AK-së qofshin ato edhe të pa qëllimshme që në këtë rast duken të janë të tilla. OE ankues sipas nenit 33.4 të RRUOPP, ka ngarkuar para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve në sistemin elektronik dokumentet e kërkuara në dosjen e tenderit për të cilat është eleminuar nga AK. Problemi i mos shkarkimit të këtyre dokumenteve rezultojnë të janë shkaktar veprimet e AK-së. Mbi këtë bazë vlerësoj se pretendimi ankimor i OE ankues është i **bazuar**.

Përgjigje në Pretendimin nr.2

Pretendimi tjetër i OE ankues eshte se OE i rekomanduar për kontratë, "Inter Trading" shpk, ka ofruar disa nga produktet me prodhuesin LUKOIL, i cili bazën e themelimit e ka në Rusi.
Gjithashtu ju njoftojmë se prodhuesi LUKOIL është në listën e subjekteve nën sanksione që nga viti 2014 me Vendim të Qeverisë së Kosovës. Për njohurinë e juaj ekzistojnë disa Vendime të mëhershme të Organit Shqyrtues të Prokurimit ku OE në fjalë e ka shpallur të papërgjegjshëm pikërisht për ofrimin e produkteve LUKOIL dhe me këtë e kanë zbatuar Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 09/196, datë 17.09.2014 për sanksione ndaj kompanisë LUKOIL. Lidhur me kete pretendim ankimor eksperti shqyrtues ka kete mendim.

Qëndron konstatimi i OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar disa produkte me prodhuesin rus "LUKOIL" i cili prodhues me vendimin nr.09/196 të datës 17.09.2014 te Qeverisë së Republikës së Kosovës i mbështet sanksionet e Institucioneve të Bashkimit Evropian dhe SHBA-së ndaj entiteteve juridike dhe autoriteteteve të Federatës Ruse për shkak të shkeljes së sovranitetit të Ukrahinës. Lidhur me këtë si ilustrim ju japim një artikull të prodhuesit rus LUKOIL të marrë nga oferta e OE të rekomanduar për kontratë. Shih më poshtë artikullin.

LUKOIL OIL COMPANY

LUKOIL Lubricants Europe GmbH

LUKOIL AVANTGARDE ULTRA 15W-40

Product number: 568321

Super-High-Performance-Diesel (SHPD) multigrade motor oil

APPROVALS

API CI-4/ SL
Cummins CES 20078
Deutz DQC III-10
Mack EO-N
MB-Approval 228.3
MTU Oil Category 2
Renault VI RLD-2
Volvo VDS-3

MEETS REQUIREMENTS

ACEA E7
Caterpillar ECF-2/ ECF-1-a
Cummins CES 20071/ 72/ 76/ 77
DAF
Detroit Diesel DFS 93K215
Mack EO-M Plus
MAN M 3275-1
ZF TE-ML 03A/ 04P/ 07D

PRODUCT DESCRIPTION

LUKOIL AVANTGARDE ULTRA 15W-40 is Super-High-Performance-Diesel (SHPD) multigrade motor oil for mixed vehicle fleet, operating under extrem conditions. Also suitable for passenger car petrol and diesel engines without particle filter.

LUKOIL AVANTGARDE ULTRA 15W-40 high alkali reserve provide longtime corrosion protection and extended oil change intervals.

LUKOIL AVANTGARDE ULTRA 15W-40 prevents bore polishing, piston deposits and enhanced engine life.

APPLICATION

LUKOIL AVANTGARDE ULTRA 15W-40 is a motor oil for high performance diesel and gasoline engines including turbo-charged engines, especially for long oil change intervals.

LUKOIL AVANTGARDE ULTRA 15W-40 can be mixed with other branded oils with the same specification level. But the full range of perfomance is only guaranteed if used pure. It should not be used in petrol engines due to the special diesel engine formulation.

For detailled information about your vehicle's lubrication and specifications, please refer to the manufacturer's user manual.

Sa i përket pikës tejtër të këtij pretendimi se ka vendime të OSHP-së, që OE i rekomanduar për kontratë është shpallë i pa përgjegjshëm për shkak të ofrimit të produkteve të prodhuesit LUKOIL, theksojm se OE ankues nuk ka ofruar dëshmi për këtë konstatim. Konkretisht me cilin vendim të OSHP-së është eleminuar si i pa përgjegjshëm OE i rekomanduar për kontratë tani. Prandaj marrë në përgjithësi eksperti shqyrtues e vlerëson këtë pretendim ankimor **pjesërisht të bazuar**.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Autoriteti kontraktues ka eleminuar ofertën e OE anukues si te papërgjegjëshme për shkak të gabimeve të vet autoritetit kontraktues që i ka bërë me rastin e krijimit të çeslave të dyfisht për të njëjtën procedurë në sistemin elektronik të prokurimit. Si rezultat i kësaj AK nuk ka arritur të shkarkoj ofertën e plotë të OE ankues edhe pse e njëjta ka qenë e ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimit. E theksuam edhe më lartë që situata të tilla nuk parashihen në RRUOPP për të ofruar zgjidhje. Megjithëatë eksperti shqyrtues mendon që AK duhet të kërkoj sqarime shtesë te OE ankues në bazë nenit 59.2 dhe 72.2 për dokumentet të cilat nuk ka arritur ti shkarkoj nga sistemi elektronik dhe nëse këto dokumente ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive të pranohen si valide. Është rekomanduar për kontratë oferta e cila ka ofruar çmimin dukshëm më të lartë mbi 31.000,00 € se oferta e OE ankues. Pra nuk janë respektuar drejtë dispozitat e nenit 1, 7, 59 dhe 72 të LPP-së.
Eksperti shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit te pretendimit ankimor i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues "Ballkan Petol" SH.P.K të **aprovohet** si pjesërisht e bazuar.
Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të bëjë **Rivlerësimin** e ofertave për aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me vaj, antifriz dhe glukol për Ndërtesat Qeveritare dhe Pallatin e Drejtësisë" me nr. te prok. 214-22-1056-121** në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:
- Autoritetit Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
- Panelit Shqyrtues OSHP dhe
- OE ankues "Ballkan Petrol" SHPK